



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo- Republika Kosova

Komuna Obiliq- Obiliq Municipality-Opština Obilič



KOMUNA E OBILIQIT



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIČ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazna

ZYRA E PROKURIMIT

Nr.
Br.

XIII-311

Data

15-08-2019

Datum

OBILIQ-OBILIČ

K O N T R A T Ë

Nr.:048/2019

Nr	Titulli I Projektit
	Hulumtimi ,Analiza,konsultimi dhe furnizimi me dokumentacion të nevojshëm si dhe ofrimi i shërbimeve profesionale për këtë projekt{projekti i Kogjenerimit}

Gusht/2019

Obiliq

PJESA B: KONTRATA PUBLIKE KUSHTET & ANEKSET E NDËLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA PUBLIKE

KOMUNA E OBILIQIT-zyra e prokurimit Rr. „Adem Jashari”15000- Obiliq

(vazhdim “Autoriteti Kontraktues”), ne njerën anë;

dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik Enggroup SH.P.K.; ITEG Sh.p.k., nga Prishtina

Adresa: " , Vëllezrit Gërvalla Bll.8, 10000, PRISHTINË NRB. 70226268 NRF. 600317540

Përfaqësuar nga: Kreshnik Shehu Drejtor

(ne vazhdim “Furnizuesi), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizim me:

TITULLI I KONTRATËS: Hulumtimi ,Analiza,konsultimi dhe furnizimi me dokumentacion të nevojshëm si dhe ofrimi i shërbimeve profesionale për këtë projekt{projekti i Kogjenerimit}

me numër identifikues: **OB614-19-4241-2-1-1 & Nr i brendshëm 614 19 048 211**

Numri i kontratës:048/2019

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratë publike është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për dorëzimin e mallrave në vijim:

Lënda e kësaj Kontrate ka të bëjë me Pegaditëjen e Projektit për ndërtimin e Sheshit për Qytetin e Komunës së Obiliqit

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuar, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit,

1.4 Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do të lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësive , për shembull në rast se autoriteti kontraktues vendosë të blejë me pak apo me shumë sasi se sa ato të parapara të

1.5 Kjo kontratë publike ka kohezgjatje prej 120 ditë dhe është efektive

prej datës në të cilën ajo hyn në fuqi.

1.6 Kontrata hynë në fuqi me {15-08-2019} dhe përfundon mbrenda {120}dite

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për fillim do të jetë {3-5 ditë} ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të projektit do të jetë { Vendi i performimit të shërbimeve është:Dep.i infrastruktures lokale rr.„Adem Jashari”Komuna e Obiliqit }

2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Furnizuesi.

Vlera totale e kontratës është **418.600,00 €** (katerqind e tetumbdhjetmi e gjashtëqind Euro 00/100

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës publike.

4.3 [shëno njerën]

[Çmimet per njësi janë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë]

4.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;
- (g) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet




6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët [[Shqipe]² in në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Sherif Hoti	Emri:	Xhafer Gashi
Pozita:	ZPP	Pozita:	ZKA
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	15-08-2019	Data:	15-08-2019
Vula:		Vula:	

Për Kontraktuesin

Emri:	Kreshnik Zhehu
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	15-08-2019
Vula:	

¹⁸ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

PJESA II E KONTRATES KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **“Kontratë”** do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 **“Shërbimet”** do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 **“Ofrues i shërbimeve”** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 **“Personeli”** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 **“Çmimi i kontratës”** do të thotë shumën e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 **“Nënkontraktuesi”** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 **“Palë”** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “Palët” nënkupton të dy prej tyre.

1.8 **“Autoriteti Kontraktues”** nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 **“KPK”** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **“KVK”** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
- b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një palë të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktonte pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Të gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeht lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij

sipas kontratës.

Neni 5 Tatimet dhe Doganat

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve

6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose në një datë tjetër të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.

6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzoj Autoritetit Kontraktues për miratim një Program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.

6.3 Ofruesi i Shërbimeve do të filloj shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrat me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.4 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në KVK. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

6.5 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

6.6 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushtron brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit

7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) forca madhore siç është e definuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimin për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmëroj palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasat ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënua për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetojë Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës;
- (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja nga ana e Ofruesit të Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafët të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai,

duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrin. Ekzekutimi i urdhrin administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve është konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të jenë bashkërisht dhe vazhdimisht të obliguar t'i plotësojnë kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi që të veprojë në emër të tij për qëllime të kësaj kontrate do të ketë autoritetin që të lidh konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojë personelin kyç të identifikuar në tender e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë ekzekutimit, dhe në bazë të kërkesës me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë për një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryen detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kryesor, vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë janë thelbisht të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

Neni 12 Obligimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion të tij, që mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë që është e mundur me Ofruesin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kërkojë në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i ceku në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e likuiduara

13.1 Ofruesi i Shërbimeve do të paguajë dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkalojë shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofruesit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikojë në detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse Data e përfundimit është zgjatur pasi që janë paguar dëmet e likuiduara, Autoriteti kontraktues do të përmirësojë çdo pagesë të tepërt të dëmeve të likuiduara nga ofruesi i shërbimit, duke rregulluar certifikatën e ardhshme të pagesës.

Neni 14 Siguria e ekzekutimit

14.1 Ofruesi i Shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizojë Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosëkzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Siguria do të vazhdojë të jetë valide 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marrë dhe do të ruajë, dhe do të shkaktojë Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofrojë dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet e përgjithshme të pagesës

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i behet Ofruesit të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate do të specifikohen në KVK.

16.2 Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.3 Shumat duhet të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

Neni 17 Kontrolli i kualitetit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është si në KVK.

Neni 18 Korrigjimi i defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) Dëme të përgjithshme; ose
- b) Dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhën Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta


KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë [Gjuha Shqipe]
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është <i>[shëno datën]</i> . Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët
	6.4	Data e Përfundimit është <i>[shëno datën]</i> . Ofruesi i Shërbimeve do të përfundojë aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në 120 Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është <i>në teritorin e komunës së Obiliqit</i>
Obligimet Autoritetit Kontraktues	12.3	AK cakton “Menaxherin e Projektit”, me vendim, , i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues
Dëmet likuiduara	13.1	Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve..
Siguria ekzekutimit	14.1	Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizojë Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë është 10% e vlerës së kontratës . Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve. Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i	15.1	Ofruesi i Shërbimeve do të marrë dhe do të ruajë, dhe do të shkaktojë Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

shërbimeve		15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar. a) /
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar , i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare. /
Kontrolli i kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jetë gjatë gjithë kohës. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është deri në realizimi dhe pranimin përfundimtarë projektit
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën. 20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë: a) vendim nga gjyqi; kompetente në Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

PJESA IV E KONTRATËS: MODEL I SIGURISË SË EKZEKUTIMIT

	ELSIG Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.	<i>Gjithçka që duhet ta keni</i>
Deklaratë e Garantuesit SIGURIA E EKZEKUTIMIT		
Pjesë përbërëse e Polices me Nr. 77094		
Për KUVENDI KOMUNAL OBILIQ (Emri i "Autoritetit Kontraktues")		
Në emër të ENGGROUP SH P K (Emri dhe adresa e "Operatorit Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatorit Ekonomik)		
Titulli i aktivitetit të prokurimit: Hulumtimi Analiza konsultimi dhe furnizimi me dokumentacion të nevojshëm si dhe ofrimi i shërbimeve profesionale për këtë projekt projekti i Kogjenerimit Nr. prokurimit: OB614 19 4241 2 1 1 , Nr. brendshëm: 614 19 048 211		
Garancion me kërkesë të parë		
Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.		
Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: 41,860.00€ zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:		
a. Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe; b. Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbetur pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.		
Pagesa në shumën e limituar prej 41,860.00€ siç është lartëcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.		
Kjo siguri vlenë deri më 15.01.2020 ora 13:51:48		
Data lëshimit: 15.08.2019 Nënshkrimi dhe vula e garantuesit		
		
		
Nr. i Serisë: 0045033		
KS "ELSIG" Sh.a Prishtinë, Adresa: Rr. "Tringë Ismajli"-rr.3 Tel: +381 (0) 38 221 112; Fax: +381 (0) 38 221 115, E-mail: office@kselsig.com		

PJESA II: IDENTIFIKIMI FINANCIAR

SHËNIME:

Pagesa

Transfer Bankar

Koment

:

Emri

: ENGGROUP SH.P.K.

Llogaria No

: 1110188591000140 ProCredit Bank

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: OB614-19-4241-2-1-1

Titulli i kontratës: Hulumtimi ,Analiza,konsultimi dhe furnizimi me dokumentacion të

nevojshëm si dhe ofrimi i shërbimeve profesionale për këtë projekt{projekti i Kogjenerimit}

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë

nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e

saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura,

pa rezervë apo kufizim:

1 Hulumtimi ,Analiza,konsultimi dhe furnizimi me dokumentacion të nevojshëm si dhe ofrimi i shërbimeve profesionale për këtë projekt{projekti i Kogjenerimit}

3. Çmimi total i tenderit është: 418.600,00 EUR Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 90 nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para

nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në

konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke

tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se

të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se

partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të

secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit

kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten

në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e

mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të

gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si

rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

B66 Formulari i dorëzimit të tenderit 4

8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e

rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj

nesh nëse e bën këtë.

Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

PARAMASA DHE PARALLOGARIA					
Identifikimi, Analiza, konsolidimi dhe formimi i informacionit ekonomik dhe treguesve dhe ofrimi i detyrave profesionale për secilin projekt					
Nr	PËRSHKRIMI	NIËSIA	SASIA	ÇMIMI	SHUMA
A	Hartimi i projektit Kryesor sipas specifikimit teknik (përshkrimit të detyrave) dhe kërkesave të AK				
1.1	NGROHJA QENDRORE PER QYTETIN E OBILQIT ME BRETHINE (Qyteti i Obilqit, Millosheva, Uazareva, Plemetini, Dardhishta Mazgiti, Hade E Re, Babimost.)	cope	1.00	308,500.00€	308,500.00 €
1.2	Mbikqyrja profesionale gjate realizimit te punimeve sipas specifikimit teknik (përshkrimit të detyrave) dhe kërkesave të AK	cope	1.00	110,100.00€	110,100.00 €
Raportimet, takimet, komunikimet etj perveq ne gjuhen shqipe do te jene edhe ne gjuhen angleze apo gjermane. <i>Stafi i prezantuar ne listen e OE duhet te marr pjese ne takimet e rregullta javore te cilat do te mbahen ne zyrtar e AK.</i>					
NËNTOTALI:					418,600.00 €
REKAPITULIMI					
TOTALI					418,600.00 €

Vrejtëje:

- Të gjitha çmimet e specifikuar në tender duhet të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohet që të
- Në çmim të përfshihen të gjitha taksat e aplikuar në Kosovë, duke llogaritur edhe tvsh-në

Identifikim i operatorit ekonomik (oe)	
Emri i kompanisë:	ENGGROUP SHPK
Adresa e plotë:	RR. VELLEZERIT GERVALLA, BIL. 8, PRISHTINE
Përfaqësuar nga:	
Emri dhe mbiemri :	KRESHNIK SHEHU
Pozita	DREJTOR
Nënshkrimi:	
data:	25.07.2019
Vula	

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

- 1. Të gjitha shërbimet e kërkuara duhet të plotësojnë të gjitha standardet, normat teknike e kërkesat tjera për projektim, mbikëqyrje.**
- 2. Të gjitha shërbimet e kërkuara duhet të respektojnë plotësisht Ligjin e Ndërtimit në fuqi.**
- 3. Të gjitha shërbimet duhet të jenë konform standardeve në BE.**

Hartimi i projektit kryesor sipas kërkesave të AK

Për qëllimet e komunës Obiliqit si Investitor është e nevojshme për të bërë një projekt detal për ndërtimin e sistemit për ngrohje qendrore të qytetit me burim të ngrohjes Termo-elektrana KEK Obiliq. Impianti i bashkëprodhimit të energjisë duhet të jetë i vendosur brenda infrastrukturës ekzistuese të objektit të termocentralit të Kosova B. Burimi termik- Termocentrali i KEK-ut I gjendet në qytetin e Obiliqit.

Detyra projektuese për instalimet e makinerisë përfshinë dizajnimin e impiantit ko-gjenerimit për të ofruar shërbimet e ngrohjes për qytetin e Obiliqit që pritet të realizohet në periudhën 2020 - 2022. Projekti detal duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara nga ligjet, rregulloret administrative dhe rregulloret teknike në fuqi në Republikën e Kosovës si dhe standardeve dhe normave teknike: EN, IEC, DIN, VDI, ASHRAE.

Gjatë realizimit të dizajnit së pari të mirren parasysh rregulloret dhe normat vendore dhe në rastet kur ato mungojnë atëherë përdoren standardet dhe normat e lartëcekura.

Projekti i Makinerisë duhet t'i trajtojë të gjitha detalet teknike, normative dhe të standardeve për proceset dhe instalimet si më poshtë duke u bazuar në kushtet klimatike lokale dhe shtrirjen e terrenit në të cilin pritet të instalohet sistemi i ngrohjes qendrore.:

Përcaktimi i sasisë së nevojshme të energjisë në anën e konsumit konform standardit ISO 13790, alokimi i nagrkësës për ngrohje për numër më të madh të konsumatorëve duke përdorur rritjen e parashikuar të energjisë për jetëgjatësinë e sistemit të ngrohjes.

Përcaktimi i shtrirjes së tubacionit për distribuimin e ngrohjes me gypa paralel të paraizoluar sipas standardit EN 253, EN 448, EN 488, EN 489 dhe EN 14419

Dimensionimi i tubacionit të rrjetës primare prej konsumtorit fundor deri të Nënstacioni për pranimin e nxehtësisë si dhe elementeve fazonike duke përdorur gypa të paraizoluar në përputhje me standardet EN 10217, EN 10253, EN 10217 etj.

Dimensionimin e nënstacioneve të konsumatorët fundorë duke përdorur stacionet termike kompakte si sisteme indirekte të ngrohjes së ndërtesave, alokimi i nagrkësës për ngrohje për numër më të madh të konsumatorëve duke përdorur rritjen e parashikuar të energjisë për jetëgjatësinë e sistemit të ngrohjes. Të gjithë Kembyesit të konsumatorët fundorë duhet të jenë në pajtim me kërkesat e standardit EN 1148.

Dimensionimi i stacionit për pranimin e energjisë termike më këmbyes pllakor me të gjitha pajisjet përcjellëse: sistemi shpërndarës dhe përmbledhës (kolektorët), sistemin e pompimit, sistemi e mbajtjes së shtypjes, sistemin rregullues, sistemin për matjen e temperaturave, sistemi për zbutjen e ujit, sistemin e monitorimit (SCADA), sistemin për matjen e konsumit të energjisë dhe lexim në largësi,

Dimensionimi i rrjetës së transmisionit në mes të Stacionit për Pranimin e Nxehtësisë dhe Stacionit për Nxjerrjen e nxehtësisë me gypa paralel të paraizoluar sipas standardit EN 253, EN 448, EN 488, EN 489 dhe EN 14419

Dimensionimin e këmbyesit të nxehtësisë (avull/ujë) i tipit gypor për presione të larta në stacionin për nxjerrjen e nxehtësisë që nënkupton dimensionimin e këmbyesit, elementeve lidhëse nga këmbyesi në drejtim të stacionit për pranim të nxehtësisë, elementeve lidhëse, rregulluese, sistemit të pompimit, sistemin e mbajtjes së shtypjes, sistemin rregullues, sistemin për matjen e temperaturave, sistemi për zbutjen e ujit, sistemin e monitorimit (SCADA) (verejtje : Pa pëlqimin e menaxhmentit të KEK, dimensionimi i tubacionit dhe elementeve tjera lidhëse, rregulluese, monitoruese nga dalja e Turbinës deri në këmbyes për nxjerrje të nxehtësisë nuk është detyrë projektuese në këtë fazë dhe kjo duhet të bëhet ekskluzivisht dhe në kordinim të ngushtë me sektorin përgjegjës në KEK dhe në pajtim të plotë me rekomandimet e dhëna nga menaxhmenti dhe inxhinierët përgjegjës në KEK për sasinë e energjisë dhe kapacitetin që mund të nxirret).

Kalkulimet shitesë që lidhen me energjinë primare sipas EN 15603 dhe energjisë të rinovueshme sipas EN 15316-4-5(2007) në rast se mungojnë rregulloret vendore

- Kalkulimi i humbjeve në rrjet
- Kalkulimi i presionit diferencial si dhe presionit punues të pajisjeve sipas direktivës për pajisje në presion – standardit EN 1434 dhe paraqitja e diagramit të rënies së presionit diferencial nga pompa deri te pika fundore ,
- Vlerësimi i sasisë së rrjedhjes në masë apo vëllimore të ujit, përcaktimin e karakteristikave- rekomandimeve për kualitetin e ujit që përdoret në sistemin e ngrohjes së qytetit sipas standardit EN 1717
- Sistemi Qëndror i kontrollës -teknologjia për lexim automatik nëpërmes qifit të senzoreve në gypin e dërgimit dhe kthimit, sensorin e rrjedhje sipas Direktivës EN 1434 “MID”,
- Zgjedhjen e pompave dhe kalkulimin e mundit të tyre për të përballuar presionin e rrjetës mbi PN 10 bar apo me të lartë,
- Ofrimin e sistemit për të mundësuar rregullimin sipas diagramit rrëshqitës- valvolave rregulluese
- Përcaktimi i sistemit ekspandues dhe mbajtjen e presionit në rrjet, valvolave siguruese, filtrave,
- Sistemi për lexim në largësi si dhe montorimi i temperaturës dhe qarkullimit
- Sipas standardit EN15603 faktorët dhe koeficientët marginal mund të aplikohen për kalkulimin e indikatorëve të përfomancës energjetike
- Zgjedhja e materiale të bëhet për të përballuar presionin nga 1.0-2.5 Mpa, varësisht prej sektorit që trajtohet dhe presionit punues.
- Sistemi të dimensionohet për $D_t=45^\circ\text{C}$
- Në rast të apikimit të materialave të ndryshme ato duhet të zgjedhen në atë mënyrë që të pamundësojnë paraqitjen e korodimit në vendet lidhese apo në mes të këtyre materialeve.

Dokumentacionet:

- Kushtet nominale të operimit
- Karakteristikat elektromagnetike dhe kufijt e poshtëm dhe të sipërm të regjimit të punës
- Specifikacionet teknike të materialeve për stacionet termike, rrjetën e gypave, stacioneve kompakte etj.
- Vizatimet dhe skemat detale të rrjetës së transmisionit, elementeve lidhëse, këmbyesve të nxehtësisë, stacionit për nxjerrjen e nxehtësisë stacionit për pranimin e nxehtësisë, stacioneve kompakte, rrjetës distributive me të gjitha pjesët përcjellëse.

Mbikëqyrja profesionale inxhinierike e punimeve për punët e kontraktuara

Mbikëqyrja profesionale inxhinierike e punimeve do të fillojë me fillimin e punimeve të kontraktuara dhe do të zgjasë gjatë tërë kohës deri sa të përfundojë kontrata. Detyrë e ofruesit të shërbimeve është të planifikojë dhe koordinojë aktivitetet që janë të lidhura me ekzekutuesit e punimeve dhe të bëjë mbikëqyrjen e plotë të punimeve duke i plotësuar të gjitha kërkesat me ligj të ndërtimit dhe rregulloret tjera në fuqi. Ofruesi i shërbimeve duhet të ketë parasysh se zgjatja ose shkurtimi i afatit të përfundimit të kontratës nuk do të thotë zgjatja ose shkurtimi i pagesave të tij, të përcaktuara për atë kontratë pune. Ai duhet ta organizojë vetë mbikëqyrjen deri në përfundim të kontratës së ekzekutuesit të punës, gjegjësisht projektit përkatës.

Varësisht, prej rëndësisë së punës, ofruesi i shërbimeve duhet të parashoh mbikëqyrjen e mjaftueshme, nëse është nevoja edhe mbikëqyrjen permanente në vend-punishite, duke e përcaktuar një person që do të qëndrojë në vend-punishite vazhdimisht, ndërsa, profilet tjera të ekspertëve t'i koordinojë përmes ekspertit permanent sipas nevojës.

Ofruesi i shërbimeve duhet të plotësojë detyrat e mëposhtme:

- Mbikëqyrja e përgjithshme e punëve dhe raportimi i rregullt javor;

- Elaborimi dhe mbikëqyrja e përgjithshme e afatit kohor;
- Testimi dhe inspektimi i materialeve dhe pajisjeve në punishte, pranimi i furnizimeve të shpërndara në punishte;
- OE duhet të jete prezent gjate marrjes se mostrave per ateste te nevojshme, dhe duhet te jete prezent edhe gjate shqyrtimit te mostrave ne Laboratorin e licencuar ne te cilin behen atestet e kerkuara nga AK.
- Kontrolli i zbatimit të ekzekutimit të punëve sipas dokumentacionit teknik, gjegjësisht, sipas paramasës, planeve e skicave dhe sipas rregulloreve e standardeve teknike;
- Testimi dhe inspektimi i punimeve të kompletuara, pranimi, plotësimi dhe nënshkrimi i dokumentacionit të projektit;
- Hapja dhe mbajtja e ditarit ndërtimor, etj. sipas Ligjit për Ndërtim;
- Organizimi i rregullt javor dhe koordinimi i mbledhjeve javore në vend-punishte në mes të kontraktorit, mbikëqyrësit dhe investitorit, raportimi tek AK rreth takimit javor;
- Përgatitja e procesverbalit të mbledhjes pas vizitave-inspektimit në vend-punishte;
- Miratimi i planit për ekzekutimin e punëve;
- Koordinimi i të gjitha palëve të përfshira, miratimi i elaborateve, vizatimeve nga palët e treta;
- Intervenimi në shtyrjet e punëve nga ekzekutuesi i punimeve;
- Përcjellja e planifikimeve dhe shpenzimeve;
- Kontrollimi dhe nënshkrimi i situacioneve të punëve të përfunduara;
- Elaborimi dhe nënshkrimi i kërkesave për pranim dhe përcjellje tek autoriteti mbikëqyrës dhe sigurimi i asistencës në pranim;
- Asistimi në procedurat e pranim-dorëzimit, duke formuluar të gjitha dokumentet relevante për pranim-dorëzim përfshirë raportet, testet dhe procedurat e pranim-dorëzimit;
- Mbikëqyrja dhe kontrollimi i funksionit të përgjithshëm të instalimeve të reja;
- Përgatitja e të gjitha raporteve teknike përfundimtare përfshirë dokumentacionin e kërkuar.

Detyra tjera mund të kërkohen nga ofruesi i shërbimeve sipas nevojave që mund të lindin gjatë ekzekutimit të punëve.

Mbikëqyrja e të metave obliguese

Mbikëqyrja gjatë periudhës obliguese të të metave do të përfshijë të gjitha aktivitetet pas ndërtimit - renovimeve deri në pranimin përfundimtar të punëve. Këtu përfshihen:

- Mbikëqyrja e projektit të përfunduar përfshin eliminimin e defekteve gjatë periudhës obliguese të të metave dhe inspektimin final të punëve;
- Asistimi në pranimin përfundimtar;
- Përgatitja e raportit final në përfundim definitiv të punëve.

Raportimi

Ofruesi i shërbimeve duhet të dorëzojë raporte javore, mujore (në raste të caktuara edhe më shpesh-raport javor ose ditor) për aktivitetet e tij (duke përfshirë problemet që ka hasur dhe zgjidhjen e propozuar) tek Autoriteti Kontraktues gjatë periudhës së kryerjes dhe periudhës obliguese të të metave.

Verejte:

Ofruesi i shërbimeve sipas nevojave që mund të lindin gjatë ekzekutimit të punëve, raportet/kontrollimet & të gjithë komunikimet mes AK duhet ti beje ne dy gjuhe : 1.Gjuhe shqipe, 2.Gjuhe angleze apo Gjermane (varesisht nga kerkesa e AK & Donatorit/Invesitorit).

Vlera investive e parashikuar ne baze te **Studim te fizibilitetit për ndërtimin e sistemit të ngrohjes qendrore në largësi {ngrohtore e qytetit me rrethinë}** eshte rreth **35,000,000.00 euro (35 milion euro).**

- AK: Kuvendi Komunal Obiliq
- Titulli: Hulumtimi ,Analiza,konsultimi dhe furnizimi me dokumentacion të nevojshëm si dhe ofrimi i shërbimeve profesionale për këtë projekt{projekti i Kogjenetimit}
- Numri i Prokurimit: OB614-19-4241-2-1-1
- Nr. i Brendshëm : 614 19 048 211

Deklarata per specifikime teknike

Me anë të kësaj shkrese deklarojmë që ne do ti përmbahemi specifikimeve teknike të Aneksit I të dosjes së tenderit, ligjeve dhe standardeve ne fuqi.



Prishtinë / 22.07.2019

- AK: Kuvendi Komunal Obiliq
- Titulli: Hulumtimi ,Analiza,konsultimi dhe furnizimi me dokumentacion të nevojshëm si dhe ofrimi i shërbimeve profesionale për këtë projekt (projekti i Kogjenerimit)
- Numri i Prokurimit: OB614-19-4241-2-1-1
- Nr. i Brendshëm : 614 19 048 211

Deklarata per caktimin e menaxherit te projektit

Konzorciumi jone deklarone qe menaxher te projektit te lartecekur cakton :

z.Driton Hyseni - Inxhinjer i Makinerise.



Prishtine 12.07.2019

- AK: Kuvendi Komunal Obiliq
- Titulli: Hulumtimi „Analiza, konsultimi dhe furnizimi me dokumentacion të nevojshëm si dhe ofrimi i shërbimeve profesionale për këtë projekt (projekti i Kogjenërimit)
- Numri i Prokurimit: OB614-19-4241-2-1-1
- Nr. i Brendshëm : 614 19 048 211

Deklarata per afatet kohore

Me anë të kësaj shkrese deklarojmë që ne do të përmbahemi afateve kohore, për fillimin dhe/ose përfundimin e kontratës, sipas FTD.

	Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës: në muaj ose në ditë 120 ose fillim përfundim
--	---



Prishtinë 22.07.2019



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije-
Ministry of Trade and Industry

Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë / Kosovska Agencija za Registracije Biznisa /
Kosova Business Registration Agency

CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT
CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
CERTIFICATE OF REGISTRATION

70226268

(Nr. i biznesit / Br. biznisa / Business No.)

"Enggroup" SH.P.K.

Emri i biznesit / Naziv biznisa / Name of Business


Lloji i biznesit
BusinessType
Tip biznesa
Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
Limited liability company
Društvo sa ograničenom odgovornošću


Adresa
Address
Adresa
Republika e Kosovës, Prishtinë, Prishtinë
Republic of Kosovo, Pristina, Pristina
Republika Kosova, Priština, Priština
, Vellezhërit Gërvalla Bll. 8

Data e inkorporimit
Date of incorporation
Datum inkorporiranjë
03/11/2009

Data e regjistrimit
Date of registration
Datum registracije
24/01/2005

20/11/2009
Data/Date/Datum


Nenshkrimi/Signature/Potpis





Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës
Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë
Ministry of Trade and Industry

ARBK

AGJENCIA E REGJISTRIMIT TË NËNSHKRIMEVE
AGENCY FOR REGISTRATION OF SIGNATURES
AGENCIJA ZA REGISTRACIJU POTPISANJA

**CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT
CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
CERTIFICATE OF REGISTRATION**

810502759

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number

Enggroup SH.P.K.

Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business

///

Emri tregtar / Trgovačko ime / Commercial name

Lloji biznesit:
Poslovni tip:
Business type:

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
Društva sa ograničenom odgovornošću
Limited Liabilities Companies

Adresa:
Adresa:
Address:

Nebih Gashi, Bll B6, Ob 2.K-1, lok 19
Prishtinë

Data e regjistrimit:
Datum registracije:
Date of registration:

24/01/2005

24/05/2019

Data / Date / Datum



Nënshkrimi / Signature / Potpis

Nr. ser. / Ser. br. / Ser. No.: 10030343



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS – VLADA KOSOVA – GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCAVE – MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSUE – MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE
ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS – PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA – TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO

CERTIFIKATË E NUMRIT FISKAL CERTIFIKAT FISKALNOG BROJA FISCAL NUMBER CERTIFICATE

NUMRI FISKAL:
FISKALNI BROJ:
FISCAL NUMBER:

600317540

STATUSI:
STATUS:
STATUS:

SH.P.K. / D.O.O. / L.L.C.

EMRI I BIZNESIT:
IME BIZNESA:
NAME OF BUSINESS:

" Enggroup " SH.P.K.

ADRESA E BIZNESIT:
ADRESA BIZNESA:
ADDRES OF BUSINESS :

Vëllezrit Gërvalla Bll.8 PRISHTINË

DATA E LËSHIMIT:
DATUM IZDAVANJA:
ISSUANCE DATE:

23-12-2009

NENSHKRIMI DHE VULA E PERSONIT PËRGJEGJES :
POTPIS I PECAT ODGOVORNOG LICA:
SIGNATURE AND ŞTAMP OF RESPONSIBLE PERSON:



Ky numër fiskal lëshohet nga Administrata Tatimore e Kosovës bazuar në Nenin 11, të ligjit Nr.2004/48 mbi Administrata Tatimore dhe Procedurat t'ndryshuar dhe plotësuar me nennin 7 të ligjit nr 03/L-071
Ovaj fiskalni broj izdaje se od strane Poreska Administracije Kosova u skladu sa članom 11. Zakona br.2004/48 o Poreska Administraciji i Postupcima, izmenjeno i dopunjeno članom 7 Zakona br.03/L-071
This fiscal number is issued by Tax Administration of Kosovo, under th Article 11 of the Law No. 2004/48 On Tax Administration and Procedure, as amended and supplemented with the Article 7 of the Law No.03/:-071

Vërejtje:

Kjo certifikat do të përdoret nga personat fizik apo juridik me qëllim të identifikimit të tyre në procedurat e deklarimit, pagesës dhe raportimit të detyrimeve tatimore ndaj ATK-së.

Napomena:

Ovaj certifikat upotrebiće se od strane fizičkih ili pravnih lica radi njihove identifikacije u postupcima deklaracija, plaćanja i prijavljivanja poreskih obaveza prema PAK-u.

Note:

This certificate shall be used by physical and legal persons in order to identify themselves in procedures of filing, payments and reporting of tax liabilities to TAK.

VERSIONI - 1 - KORIGJUAR 03-08-2009